



Planuar / Doretuar Prilidjen/Prodato Received/Delivety	08-06-2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	4638/2023		1/2



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.690/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërja nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas ankesës me numër A.nr.690/2023 të datës 28.04.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ nga _____ në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.690/2023 të datës 28.04.2023, të parashtruar nga ankues

A r s y e t i m

Ankuesi _____ më datë 28.04.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër heshtjes dhe mos veprimit të administratës së Komunës së Ferizajt lidhur me kërkesën e ankuesit të datës 08.03.2023, për pagesën e të ardhurave personale sipas koeficientit nëntë (9) si dhe kompensimin e diferencës së të ardhurave personale të pa realizuara nga data 01.02.2023 në pajtim me dispozitat e Ligjit për Pagat Nr.09/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Ndërsa ankuesi më datë 08.06.2023 përmes shkresës me numër protokolli 1626/2023, është tërhequr nga ankesa A.nr.690/2023 të datës 28.04.2023, me arsyetimin se çështja e cila është objekt i kësaj ankesë është duke u trajtuar të organi kompetent.

Andaj, Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankuesit për tërheqje nga ankesa, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.690/2023 të datës 28.04.2023.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit është i paligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.690/2023

Ardita Perguku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Dëmi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Ferizajt dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

